

STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Wow Digital "

Ne këtë statut:

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, me date 05/02/2020 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar me emrin "**WOW DIGITAL**" ShPK.

Themeluesit e shoqërisë janë:

1. **Dinejda Hysendhima** e bija e Bashkim e lindur ne Vlore dhe banuese ne Tirane e datelindjes 06.03.1986 identifikuar nepermjet kartes se identitetit me nr. Personal I65306100A.
2. **Veliona Hoxhaj** e bija e Veli e datelindjes 21.08.1994 identifikuar me ane te kartes se identitetit Nr.J45821051L lindur ne Vlore dhe banuese ne vlore lagjia 10 Korriku.

Neni 2

Objekti


Shoqëria ka për aktivitet te saj ofrimin e shërbimeve ne fushën e marketingut digjital, teknologjisë se informacionit, telemarketingut, shërbime te përkthimit, konsultimeve, publikimeve desktop "DTP Shërbime" krijimeve grafike, reklamimeve. Realizimin dhe ofrimin e çdo aktiviteti qe është brenda fushëveprimit te shoqërisë qe ka lidhje dhe është ne funksion te objektit te aktivitetit e saj.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do to jete pa afat vetëm ne rast se do te verifikohet ndonjë nga rastet e parashikuara ne nenin 18 te këtij statuti ose ndonjë event tjetër i cili mund te shkaktoj prishjen e shoqërisë sipas legjislacionit ne fuqi.





Neni 4

Selia

1. Selia e shoqërisë ndodhet ne Tirane ne adresën: “ Rruga Tish Dajia Kompleksi kika 2, Tirane”. Vendndodhja e shoqërisë mund te ndryshohet brenda qytetit te Tiranës me kërkesë te administratorit komunikuar me pare edhe ortakeve te tjerë.
2. Shoqëria mund te përcaktojë edhe dege te tjera brenda ose jashtë Shqipërisë ne përputhje me këtë statut dhe ligjin e aplikueshëm te vendit përkatës.
3. Adresa e faqes se internetit te shoqërisë është
4. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: alba7ndreu@gmail.com

KREU II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 Leke (sipas ligjit kapitali nuk mund te jete me i vogël se 100 leke). Pjesëmarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqërisë është ne përputhje me kontributet e tyre te mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Dinejda Hysendhima** zotërues i 1 (një) me vlere te përgjithshme 50.000 lek e cila përbën 50 % te kapitalit themeltar te shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Veliona Hoxhaj** zotërues i 1 (një) kuote me vlere te përgjithshme 50.000 leke e cila përbën 50 % te kapitalit themeltar te shoqërisë.

Kontributi i ortakeve mund te jete ne para (kesh) dhe ne natyre.



Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve te pjesëve te kapitalit themeltar për kontributet ne para dhe me anë te kontributeve ne natyre, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës se administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njëjtat kushte qe kërkohen për ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogëlimi i prek ortaket ne te njëjtën mase ndaj pjesëve te kapitalit qe përfaqësojnë përveç rastit qe asambleja e përgjithshme me shumice votash vendos ndryshe.



Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te shoqërisë dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër te parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme ndërmjet ortakeve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Çdo lloj transferimi kundrejt te treteve (jo ortake) duke përfshirë edhe dhurimin do te mund te kryhet vetëm nëpërmjet autorizimit te shprehur ne mënyrë paraprake nga asambleja e përgjithshme me shumice votash te pjesëmarrësve.

Çdo partner gëzon te drejtën e parablerjes me te kundrejt te njëjtit çmim i cili duhet ti jepet një afat minimal prej 3 muajsh nga momenti i komunikimit te projektit te transferimit te kuotave.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme vetëm me rruge trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendim-marres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj, Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a. përcaktimin e politikave tregtare te shoqërisë;
- b. ndryshimet e statutit;
- c. emërimin e shkarkimin e administratoreve;
- d. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabël te autorizuar;
- e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kësaj pike;
- f. mbikëqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë;
- g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë;
- h. shpërndarjen e dividendit vjetor

Arçutkuu

Idem

- i.** zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- j.** pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- k.** përfaqësimin e shoqërisë ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- l.** riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- m.** miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblesë;
- n.** çështje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te përfaqësohet ne asamblenë e përgjithshme, ne baze te një autorizimi me shkrim nga një ortak tjetër apo nga një person i trete.

Administratori i shoqërisë nuk mund te veproje si përfaqësues i ortakeve ne asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetëm për një mbledhje te asamblesë se përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me te njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrese ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postes elektronike. Ne çdo rast duhet te jete konfirmuar marrja dijeni. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 15 dite përpara datës se parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 te këtij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetëm nëse te gjithë ortakët janë dakord, për te marre vendime, pavarësisht parregullsisë.


Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kërkojnë një shumice te zakonshme, asambleja e përgjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetëm nëse marrin pjese ortakët me te drejte vote, qe zotërojnë me shume se 30 për qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e përgjithshme duhet te vendose për çështje, te cilat kërkojnë shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit " Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetëm, nëse ortakët qe zotërojnë me shume se gjysmën e numrit total te votave, janë te pranishëm personalisht, votojnë me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikës 3 te nenit 88 te këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund te mblidhet për shkak te mungesës se kuorumit te përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo me vone se 30 dite, me te njëjtin rend dite.





Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri te katërtat e votave te zotëruesve te kapitalit, te ortakeve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit te regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. (*vetëm ne rastin e fundit duhet një motiv i ligjshëm*)

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave te ortakeve pjesëmarrës, për çështje to tjera si: zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit fillestar; shpërndarja e fitimit; përcaktimi i politikave tregtare te shoqërisë; emërimin dhe shkarkimin e administratoreve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabël te autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve; miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKR për te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund ushtroje te drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a. vlerësimin e veprimtarisë se tij;
- b. shuarjen e ndonjë detyrimi ne ngarkim te tij;
- c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d. dhënien ose jo te përfitimeve te reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet te jete ne te njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin përfaqëson.


Neni 13


Administrimi

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose me shume persona fizike si administrator te shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me te drejte ripërtëritjeje. Emërimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit.

2. Administrator e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit te nenit 207 te këtij ligji, nuk mund te emërohen si administratore te një shoqërie te kontrolluar e anasjelltas. çdo emërim i bere ne kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3. Personat e mëposhtëm caktohen si Administratore te pare te shoqërisë deri





ne emërimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblesë se Përgjithshme:

- **Albana Ndreu** e datelindjes 07.04.1969

Neni 14

Kompetencat e Administratoreve

Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a. kryejnë te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarisë tregtare te shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c. kujdesen për mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabël te shoqërisë;
- d. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë se veprimtarisë dhe, se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë se përgjithshme për miratim;
- e. krijojnë një sistem paralajmërimi ne kohen e duhur për rrethanat, qe kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë te dhënat e detyrueshme te shoqërisë, siç parashikohet ne ligjin për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit;
- g. raportojnë përpara asamblesë se përgjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve to posaçme me rëndësi te veçante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h. kryejnë detyra te tjera te përcaktuara ne Ligj dhe ne statut.

Administratoret janë te detyruar te thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, ne rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- shoqëria propozon to shesë apo te disponoje ne mënyrë tjetër aktive, të cilat kane një vlere me te larte se 5 për qind te asetëve to shoqërisë, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te blejë nga një ortak pasuri, qe kanë vlere me te larte se 5 për qind te asetëve te shoqërisë, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron me shume se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme te pjesëmarrësve. Padite, qe lidhen me shpërblimin e administratorit, ne baze te marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Albana Ndreu

Albana Ndreu

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj te treteve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dem shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka balt marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidare sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme -18 detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1.
 - a. të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin me të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçante ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b. të ushtroje kompetencat që i njihen në Ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d. të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - e. të ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në të, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
 - a. u kthen ortakëve kontributet;
 - b. u paguan ortakëve interesat apo dividendë;
 - c. u shpërndan aktivet shoqërisë;

[Signature]

[Signature]

- d. lejon qe shoqëria te vazhdoje veprimtarinë tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqëria nuk do te kishte aftësi pagese për te shlyer detyrimet;
- e. jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote to demit qe i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund te ndaloje ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyrës.

Çdo administrator është i detyruar te nënshkruaj një police sigurimi ne lidhje me përgjegjësitë civile qe lindin nga ushtrimi i aktivitetit te tij për një shume 1.000.000 leke.

KREU IV

VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 16

Viti Financiar



Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjithësisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti ka për detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabël te veprimtarisë ekonomiko tregtare te shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne përfundim te kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike te ushtruara, te cilat është i detyruar qe t'jua paraqesë e dorëzoje ne kohe ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e te drejtës vendimore qe kane.



KREU V
PRISHJA —RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Neni 18
Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja a e shoqërisë mund të behet në çdo kohë :

- a. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b. me vendim të Asamblesë së Ortakeve;
- c. me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e. me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19
Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakeve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

H. Abdurrahman

Blaz

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare. Shpenzimet ligjore do të paguhet nga ortakët në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë.

Shpenzimet ligjore do të paguhet nga ortakët në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë.

ORTAKET E SHOQERISE ME PERGJEGJESI KUFIZUAR "WOW DIGITAL" :

1. DINEJDA HYSENDHIMA *Dinejda Hysendhima*
2. VELIONA HOXHAI *Veliona Hoxhaj*